

VENDIM
Nr. 1159, datë 24.12.2020

**PËR MIRATIMIN E GARANCISË SHTETËRORE, NË FAVOR TË INTESA
SANPAOLO BANK ALBANIA SHA, NË KUADËR TË KONTRATËS SË KREDISË,
NDËRMJET INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA SHA DHE KESH SHA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3 dhe 38, të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 57, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e garancisë shtetërore, në favor të Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a., në kuadër të kontratës së kredisë, ndërmjet Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a. dhe KESH sh.a., për shumën 10 295 906.00 (dhjetë milionë e dyqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e gjashtë) euro.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Korporata Elektroenergjetike Shqiptare sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe